



Në bazë të nenit 5 paragrafi (1) të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë për vitin 2026 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 36/26), Ministria e energjisë, minierave dhe burimeve minerale

shpall

THIRRJE PUBLIKE

për dhënien e vërtetimit– vauçer për blerjen dhe instalimin e pajisjeve të kondicionerëve inverter për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë për vitin 2026

Për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë, sipas Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të energjisë për vitin 2026 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 36/26) (në tekstin e mëtejshëm programi), Ministria e energjisë, minierave dhe burimeve minerale (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) jep mbështetje financiare përmes një vërtetimi – vauçer për blerjen dhe instalimin e pajisjeve të kondicionerëve inverter me kapacitet 3.5 kW i cili ka të paktën klasën e energjisë A+ (në Teksti i mëtejshëm: vërtetimi – vauçer) për:

1. amvisëri me një ose më shumë persona përfitues të kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, sipas nenit 44 të Ligjit për mbrojtjen sociale, të cilëve të ardhurat totale neto që i nënshtrohen tatimit në nivel mujor sipas Ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale të anëtarëve të familjes në vitin 2025 nuk kanë tejkalluar shumën prej:

- 30,000.00 denarë për një amvisëri të vetme,
- 45,000.00 denarë për një amvisëri me dy anëtarë,
- 63,000.00 denarë për një amvisëri me tre anëtarë, dhe
- 83,000.00 denarë për një amvisëri me katër ose më shumë anëtarë, pa përfshirë shtesën e aftësisë së kufizuar sipas Ligjit për mbrojtje sociale, dhe

2. amvisëri me një ose më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, përfitues të shtesës së veçantë deri në moshën 26 vjeç, sipas nenit 32 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, të ardhurat neto të përgjithshme të amvisërisë që i nënshtrohen tatimit në bazë mujore sipas Ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale të anëtarëve të amvisërisë për vitin 2025 nuk duhet të tejkalojnë shumën prej:

- 45,000.00 denarë për një amvisëri me dy anëtarë,
- 63,000.00 denarë për një amvisëri me tre anëtarë, dhe
- 83,000.00 denarë për një amvisëri me katër ose më shumë anëtarë, pa llogaritur shtesën e veçantë sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Gjatë përlllogaritjes së të ardhurave totale të amvisërisë që i nënshtrohen tatimit në nivel mujor, kompensimi për aftësi të kufizuar nuk përfshihet në llogaritjen e të ardhurave neto.



Nuk konsiderohet konsumator i cenueshëm sipas pikave 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike personi që shfrytëzon të drejtën për invaliditet civil ose ushtarak. Gjithashtu, për konsumator të cenueshëm sipas pikës 1 nuk konsiderohet personi i cili, me vendim të qendrës për punë sociale, është i vendosur për më shumë se 30 ditë në institucion për mbrojtje sociale jashtë familjes, familje kujdestare, formë jetese të organizuar me mbështetje, apo në institucion shëndetësor ose tjetër, për periudhën sa zgjat vendosja.

Sipas nenit 4 të Programit, aplikuesit nga kategoritë e pikës 1 dhe 2 të kësaj thirrje fitojnë të drejtën për vërtetim – vauçer për blerjen dhe instalimin e një kondicioneri inverter.

Dhënien e vërtetimit - vauçer e bën Ministria e energjisë, minierave dhe burimeve minerale përmes përzgjedhjes së kërkesave të pranuar nga amvisëritë për secilën nga kategoritë e përmendura në pikat 1 dhe 2 të kësaj thirrje, deri në shterimin e mjeteve të parashikuara sipas Programit.

Konsumatorëve të cenueshëm të energjisë sipas Programit, të cilët marrin ndihmë minimale të garantuar dhe përfitojnë shtesë financiare për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për energji në amvisëri, në përputhje me nenin 42 të Ligjit për mbrojtje sociale, si dhe personave të moshuar sipas nenit 7 të Ligjit për siguri sociale të personave të moshuar, nuk u takon vauçer nga kjo thirrje.

Afati për aplikim në këtë thirrje publike është 30 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të saj.

Kërkesa për dhënien e vërtetimit – vauçer

2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në këtë thirrje publike kanë personat nga pika 1 e kësaj thirrje, të cilët do të dorëzojnë aplikim elektronik për marrjen e vërtetimit – vauçer përmes faqes së internetit: www.aplikanti.energy.gov.mk

Për amvisëritë në të cilat jeton një ose më shumë persona përfitues të kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe për amvisëritë ku jeton një ose më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, përfitues të shtesës së veçantë deri në moshën 26 vjeç, plotësohet një kërkesë në formë elektronike që përmban të dhëna të detyrueshme. Pas kësaj, zgjidhet grupi target, përkatësisht kategoria për të cilën aplikuesi paraqet kërkesën.

Për mënyrën e aplikimit, aplikantët mund të shkarkojnë udhëzimet se si të aplikoni nga faqja e internetit e ministrisë: www.energy.gov.mk

2.2 Me kërkesën për dhënien e vërtetimit – vauçer, aplikuesi, përkatësisht **amvisëri në të cilën jeton një ose më shumë persona përfitues të kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe amvisëri në të cilën jeton një ose më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, përfitues të shtesës së veçantë deri në moshën 26 vjeç**, bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

1. Deklaratë e noterizuar me të cilën vërtetohet se gjithë dokumentacioni i bashkëngjitur kërkesës është i saktë dhe i besueshëm (formulari i deklaratës mund të sigurohet në faqen e internetit të ministrisë: www.energy.gov.mk);
2. Vendim për të drejtën e përfitimit të shtesës së veçantë sipas ligjit;
3. Letërnjoftimi i aplikuesit dhe



4. Dëshmi për anëtarët e amvisërisë së aplikuesit (kartë identiteti për personat e rritur, certifikatë lindjeje për të miturit, certifikatë martesë, vërtetim për divorc ose certifikatë vdekjeje për ndonjë anëtar të amvisërisë).

Procedura për dhënien e vërtetimit – vauçer

3.1 Kërkesa për përdorimin e mbështetjes financiare, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, dorëzohet nga aplikuesit – **amvisëritë në të cilat jeton një ose më shumë persona përfitues të kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe amvisëritë ku jeton një ose më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, përfitues të shtesës së veçantë deri në moshën 26 vjeç** – dorëzohen në formë elektronike përmes faqes së internetit www.aplikanti.energy.gov.mk;

3.2 Parashtruesit e kërkesës duhet që në kërkesë të shënojnë emrin dhe mbiemrin e personave për të cilët është lëshuar vendimi si përfitues të kompensimit të veçantë sipas ligjit. Ata duhet të dorëzojnë kërkesë të rregullt dhe të plotë me të gjitha dokumentet e nevojshme. Nëse kërkesa e paraqitur është e parregullt dhe jo e plotë, Komisioni, në përputhje me nenin 39, paragrafi 3 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 124/2015 dhe 65/2018), do t'i drejtohet aplikuesit dhe do të kërkojë që brenda afatit prej 8 ditësh të bëjë rregullimin dhe plotësimin e kërkesës.

Një person mund të dorëzojë vetëm një kërkesë për vërtetim – vauçer për një amvisëri.

SHËNIM: Ministria e energjisë, minierave dhe burimeve minerale, në detyrë zyrtare, përmes Ministrisë së politikës sociale, demografisë dhe rinisë do të kryejë kontroll mbi të drejtat e përfituara për mbrojtje sociale në amvisëritë e aplikuesve, ndërsa përmes Drejtorisë për të ardhura publike do të kryejë verifikimin e të ardhurave totale neto që i nënshtrohen tatimit sipas Ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale të anëtarëve të amvisërisë në vitin 2025.

Mënyra e realizimit të së drejtës

4.1 Për zbatimin e aktiviteteve për realizimin e vërtetimit – vauçer nga programi, ministrja formon dy komisione, secili i përbërë nga tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre nga radhët e punonjësve të Ministrisë.

4.2 Komisionet shqyrtojnë kërkesat e dorëzuara deri në ditën e fundit të afatit të thirrjes publike, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, dhe përcaktojnë numrin e saktë të kërkesave të dorëzuara që janë të rregullta dhe të plota. Sipas memorandumit të bashkëpunimit, komisionet do të kërkojnë nga Ministria e politikës sociale të verifikojnë nëse anëtari ose anëtarët e amvisërisë janë përfitues të shtesës së veçantë për shkak të aftësisë së kufizuar sipas nenit 44 të Ligjit për mbrojtjen sociale.

4.3 Personat që kanë dorëzuar kërkesë, por nuk kanë dokumentacion të rregullt dhe të plotë, ose nuk e rregullojnë dhe plotësojnë dokumentacionin e dorëzuar brenda afatit të caktuar nga Komisionet, nuk do të fitojnë vërtetimin – vauçer.



MINISTRIA E ENERGJISË,
MINIERAVE DHE BURIMEVE MINERALE

4.4 Komisionet, për personat që kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt dhe të plotë, i propozojnë ministrin së energjisë, minierave dhe burimeve minerale të marrë vendim për dhënien e vërtetimit – vaçer.

4.5 Lista e personave që kanë fituar vërtetimin – vaçer sipas programit, publikohet në faqen e internetit të Ministrisë, ndërsa vendimet e marrë në formë elektronike i dërgohen aplikuesve përmes rrugës elektronike.

4.6 Lista e personave që nuk kanë fituar vërtetimin – vaçer sipas programit publikohet në faqen e internetit të Ministrisë, ndërsa vendimet e marra dërgohen përmes rrugës elektronike.

